



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
MUNICIPALITY -SUHAREKË



Datë: 11/07/2024

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-13687 të datës 29/02/2024 të asamblesë komunale për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1 (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunes, dhe në bazë të vendimit të Asamblesë Komunale 01-Nr-016-24235 të datës 29/04/2024 për formimin e komisionit, në bazë të procesverbalit nr. 01/2024 të datës, 05/07/2024 Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunes, Rregullorja (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunes, komisioni me datë 11/07/2024 shpallë:

## ANKAND PUBLIK

Nr.02/2024

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

- 1.1 Lokalin afaristi i cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **48.7m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-60-1-3-0** me numër të certifikatës **Nr. 350-2024**, të datës **08.02.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtur **“Gradina”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunes së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor.
- 1.2 Lokalin afaristi i cili gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, me sipërfaqe të përgjithshme prej **48.7m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **O-72116046-60-1-4-0** me numër të certifikatës **Nr. 470-2023**, të datës **08.02.2024**, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtur **“Gradina”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunes së Suharekës, për ushtrimin e aktivitetit biznesor.

### Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë;për personat juridik – Taksa Komunale, dhe tatimi në pronë),
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)
5. Deklarata nën betim për vizitën e lokaleve afariste.

### Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara;
- Çmimi fillestar për m<sup>2</sup> të parcelës (referuar rregullores së Komunes– min 5 €/m<sup>2</sup> në muaj) vlerohet / me **60 pikë**;
- Projekti ideor konceptual lidhur me zhvillimin e aktivitetit afarist biznesor vlerohet/ me **20 pikë** ;
- Numëri I punëtorëve dhe plani dinamik 12 muaj lidhur me zhvillimin e aktivitetit biznesor vlerohet /me **20 pikë**.

**Vërejtje:**

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim;
- Veprimtaria **jo adekuate** (referoju planifikimit hapsinore per ate zone) do të diskualifikohet nga ankandi;
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik;
- Aplikuesit obligohet që të vizitoj lokalet para mbylljes së ofertës dhe të njihet me gjendjen ekzistuese.
- Të gjithë të interesuarit për aplikim në këtë ankand publik dhe të interesuarit për vizitë te lokaleve që janë pjesë e këtij ankandi duhet të drejtohen tek zyret e Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë 25/07/2024 , zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave deri më datë **25/07/2024** deri në ora **14:00**, oferta duhet të jetë e protokoluar te zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me **25/07/2024** në ora **14:30** në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfutuesin e rekomandon komisioni dhe e vendos Kryetari i Komunës konform ligjit nr.04/L-144.

Informatat shtesë ;

Nr. tel: 029 271 708

049-563-420

armend.m.krasniqi@rks-gov.net

**Kryesuesi I komisionit**

